

VENDIM
Nr. 123, datë 4.6.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS SË
OPERIMIT NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
SHOQËRISË OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE SHA
(OSHEE SHA), ME NR. 250, SERIA P14SH, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË KOMISIONERVE TË ERE-s NR. 96, DATË 27.10.2014, E VLEFSHME DERI MË
DATË 27.10.2044 TE SHOQËRIA “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES”
SHA (OSSH SHA)**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “c”, 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “c”; 5, pika 1 germa “c”; 10, pika 1, si dhe të nenit 17, pika 1, pikat 2, 4 dhe 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19 pika 1, germa “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 4.6.2018 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për transferimin e licencës së operimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e bordit të komisionerve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, e vlefshme deri në datën 27.10.2044 të shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.),

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a. është licencuar në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014 dhe mban licencën me nr. 250, seria P14SH.

- Me shkresën nr. 1090/1 prot., datë 6.4.2018, OSHEE sh.a. ka bërë me dije themelimin e shoqërisë “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes”(OSSH), në zbatim të Ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe urdhrin të Asamblesë së Përgjithshme nr. 157 prot., datë 12.2.2018 të shoqërisë OSHEE sh.a. në cilësinë e Aksionarit themelues. Data e themelimit është 28.3.2018, me ofertë private, me objekt aktiviteti shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve, lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike etj., si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë, me NUIS L81530018E.

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën me nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, protokolluar në ERE me nr. 355, datë 30.4.2018, ka përcjellë dokumentacioni për transferimin/licencimin e shoqërive të kontrolluara nga OSHEE sh.a..

- Shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH) me shkresën nr. 2 prot., datë 27.4.2018, ka paraqitur në ERE kërkesën për transferimin licencës së shpërndarjes të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërive “OSHEE” sh.a. dhe “OSSH” sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në bazë të nenit 10, pikat 1 dhe 2, si dhe nenit 17 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim (neni 17, pika 2, germa “a”, formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1, gjerat “a”, “b” “c”) plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 17, pika 2, germa “b”, dokumentet juridike, administrative dhe pronësore sipas nenit 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 17, pika 2, germa “c”, dokumentet financiare dhe fiskale sipas nenit 9, pika 3 gjerat “b”, “c”, “d”), plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 2, germa “d”: (çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike.) Diagrama e sistemit të shpërndarjes që tregon elementet ekzistues dhe ata të perspektives – Subjekti nuk deklaron që ka modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike ose reflektim të ndryshimeve.

- Neni 17, pika 4, germa “a” (formati i aplikimit sipas nenit 9, pika 1), plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 17, pika 4, germa “b” (një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për transferimin e licencës), plotësuar në mënyrë korrekte.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 3 germa “a” (vërtetime që shoqëria nuk ka detyrime për tatimtaksa dhe ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore);

- Nenin 17, pika 4, germa “c” (vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit që shprehin vullnetin për të kërkuar transferimin e licencës), do të njoftohet shoqëria që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transferim e licencës së Operimit në Sistemin e Shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a. (OSHEE), mbajtëse e licencës nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2044 të shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH),

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti